



Datë: 12.06.2025
Numër Protokolli: 3981/2025

A.nr.863/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtar, me Driton Jashari, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.863/2025, të datës 12.05.2025, të parashtruar nga ankuesja S.H., kundër organit të punësimit/Ministritsë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.863/2025, e datës 12.05.2025, e parashtruar nga ankuesja S.H.

A r s y e t i m

S.H.(*tutje referuar vetëm ankuesja*), përmes e-mailit të datës 12.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër listës së renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 11.04.2025, për konkursin e punës me nr. Reference RN00016299 të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa ankuesja më datë 04.06.2025 është tërhequr nga ankesa, sipas kërkesës së saj të parashtruar përmes e-mailit, të regjistruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 3826/2025 më datë 05.06.2025.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së ankueses për tërheqje nga ankesa, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.863/2025 të datës 12.05.2025.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.863/2025

Driton JASHARI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses S.H.;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPB;
- Arkivit të KPMSHCK-së.